



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

**Federata e Basketbollit
të Kosovës**

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

RREGULLORE E PUNËS SË KËSHILLIT MBIKËQYRËS SË FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Prishtinë, 23.03.2026



Në bazë të nenit 20, alineja 1.4. të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Kuvendi i FBK-së, në mbledhjen e mbajtur me datën 23.03.2026 miraton këtë:

RREGULLORE E PUNËS SË KËSHILLIT MBIKËQYRËS

NENI 1 - Funkzioni i Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës është organ mbikëqyrës i Federatës, i cili kujdeset për punën, ligjshmërinë dhe për veprimtarinë materialo-financiare të FBK-së.
2. Këshilli mbikëqyrës përbëhet nga tre anëtarë (Kryetari dhe dy anëtarë), të zgjedhur nga Kuvendi i Federatës me mandat katër (4) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.
3. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të jenë anëtarë të organeve dhe trupave punuese tjera të Federatës. Bordi, Sekretari i Përgjithshëm dhe të gjitha trupat punuese të tija janë të obliguara që Këshillit mbikëqyrës t'ia mundësojnë mbikëqyrjen e punës së tyre.
4. Anëtarët e Këshillit mund t'i shkarkojë Kuvendi i FBK-së.

NENI 2 - Parimet e punës

1. Këshilli Mbikëqyrës punon në bazë të parimit të ligjshmërisë, të efikasitetit dhe ekonomikitetit. Mbikëqyrë, shqyrton aktet juridike, vendimet e ndryshme dhe punën materialo-financiare të FBK-së.
2. Çdo anëtar i Këshillit Mbikëqyrës duhet të deklarojë çdo konflikt interesi që lidhet me vendimet ose diskutimet gjatë mbledhjeve. Anëtari përjashtohet nga diskutimi dhe votimi për pikën ku ekziston konflikti dhe deklarimi regjistrohet në procesverbal.

NENI 3 - Raportimi

1. Këshilli tre (3) anëtarësh vendosë me shumicë votash për vendimet e tij dhe përpilon raportin me shkrim.



2. Këshilli Mbikëqyrës përgatit raport vjetor të detajuar për punën e tij dhe ia paraqet Kuvendit të FBK-së.

3. Raporti vjetor përfshin gjetjet kryesore, rekomandimet, masat e propozuara dhe vlerësimin e gjendjes financiare dhe institucionale të FBK-së.

NENI 4 - Fushëveprimi dhe kompetencat

1. Këshilli Mbikëqyrës ka të drejtë që:

1.1. të bëjë shikimin në vendimet e organeve të FBK-së;

1.2. të mbikëqyrë dhe shqyrtojë veprimtarinë materialo-financiare të FBK-së, përfshirë shpenzimet, kontratat, pagesat dhe obligimet financiare;

1.3. të shqyrtojë aktet normative dhe dokumentet e tjera që lidhen me punën dhe veprimtarinë e FBK-së;

1.4. të kërkojë dhe të ketë qasje në çdo dokument, informacion ose të dhënë që e konsideron të nevojshme për ushtrimin e funksionit të tij;

1.5. të propozojë masa korigjuese dhe rekomandime për organet kompetente të FBK-së në rast të parregullsive të konstatuara;

1.6. të kërkojë auditim të brendshëm ose të jashtëm në rast të dyshimeve për shkelje financiare ose institucionale.

2. Shërbimi i FBK-së, Bordi, Sekretari i Përgjithshëm dhe të gjitha organet dhe trupat punuese të Federatës janë të obliguara t'i vënë në dispozicion Këshillit Mbikëqyrës të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara, brenda 7-15 ditëve. Mosrespektimi konsiderohet shkelje institucionale.

NENI 5 - Ruajtja e dokumentacionit

Vendimet, raportet dhe aktet tjera të Këshillit Mbikëqyrës ruhen si dokumentacion zyrtar në arkivin e FBK-së.

NENI 6 - Informimi i Bordit dhe Kuvendit

Këshilli Mbikëqyrës për punën e vet informon Bordin e FBK-së dhe për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të FBK-së.



NENI 7 - Detyrat e Kryetarit dhe anëtarëve

1. Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës ka të drejtat dhe detyrat si vijon:

- 1.1. Organizon dhe konvokon mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës;
- 1.2. Kryeson me mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës;
- 1.3. Kujdeset për sigurimin e transparencës në punën e Këshillit Mbikëqyrës;
- 1.4. Kryen edhe detyra të tjera të caktuara me Rregulloren e Punës së Këshillit Mbikëqyrës.

2. Anëtari i Këshillit Mbikëqyrës ka të drejt që në seancë të:

- 2.1. Propozon shqyrtimin e pyetjeve nga fushëveprimi i punës të Këshillit Mbikëqyrës;
- 2.2. Shtron pyetje dhe kërkon sqarimin për çdo pikë të rendit të ditës në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës;
- 2.3. Paraqet propozime lidhur me vendimet, raportet, konkluzionet dhe aktet tjera nga fushëveprimi i punës së Këshillit Mbikëqyrës.
- 2.4. Të marrë pjesë në diskutime dhe votime, duke respektuar deklarinimin e konflikteve të interesit sipas Nenit 2 të kësaj Rregulloreje.

NENI 8 - Vendimmarrja

1. Këshilli Mbikëqyrës merr vendime dhe konkluzione, me shumicën e votave.
2. Këshilli Mbikëqyrës merr vendime kur vendosë për ndonjë nga pyetjet nga fushëveprimi i punës së Këshillit Mbikëqyrës.
3. Vendimi sipas rregullës duhet të ketë hyrjen, dispozitivin dhe arsyetimin.
4. Vendimet, raportet dhe konkluzionet e Këshillit Mbikëqyrës që lidhen drejtpërdrejt me Bordin, delegatët ose trupat punuese duhet t'u dërgohen brenda tre (3) ditëve.
5. Vendimet e Këshillit duhet të publikohen në ueb faqen e FBK-së në mënyrë transparente për publikun.



NENI 9 - Konvokimi i mbledhjeve

Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës i konvokon Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës, por mbledhjet e Këshillit mund t'i konvokoj edhe Kryetari i FBK, së paku një e treta 1/3 të anëtarëve të Bordit dhe dy (2) anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës. Rendin e ditës e përcakton konvokuesi i mbledhjes.

NENI 10 - Procesverbali

1. Në mbledhje të këshillit Mbikëqyrës mbahet procesverbali, i cili duhet të pasqyrojë rrjedhën e mbledhjes dhe vendimet / konkluzionet e aprovuara.
2. Procesverbalin duhet ta nënshkruajnë, Kryetari dhe Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, prezentë.

NENI 11 - Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Kuvendi i Federatës së Basketbollit të Kosovës.

Kryetari

Arben **FETAHU**

Federata e Basketbollit të Kosovës



Prishtinë, 23.03.2026